KOMUNA E OBILIQIT-OPŠTINA OBILIĆ
DREJTORIA E ADMINISTRATËS PËRGJITHSHME
UPRAVA OPŠTE ADMINISTRACIJE
Dalës-Izlazne
Nr. II-46 Data 29-01-2022
Br. Datum

Republika e Kosovës - Republika Kosovo - Republic of Kosova

Komuna e Obiliqit - Opština Obilić - Municipality Obiliq

Zyra e Kryetarit/Kabinet Predcednika/ Office of the Mayor

Datë/Data/Date:	**29 janar 2022**
Nga/Od/From:	**Xhafer Gashi – Kryetar i Komunës**
Për/Za/To:	**z.Glauk Konjufca- Kryetar i Kuvendit të Republikës së Kosovës,** **Komisionit Parlamentar për Ekonomi, Industri, Ndërmarrësi dhe Tregti,** **z.Albin Kurti – Kryeministër i Republikës së Kosovës** **znj.Artana Rizvanolli- Ministre e Ekonomisë** **Bordin e Zyrës së Rregullatorit të Energjisë në Kosovë**
Tema/Subjekat/Subject	**Ligji për Obiliqin,** **-koutë më të ultë të energjisë elektrike**

I nderuar Kryetar i Kuvendit të Republikës së Kosovës,
Të nderuar anëtar të Komisionit Parlamentar për Ekonomi, Industri, Ndërmarrësi dhe Tregti,
I nderuar Kryeministër i Republikës së Kosovës,
E nderuar Ministre e Ekonomisë,
Të nderuar anëtar të Bordit të Zyrës së Rregullatorit të Energjisë në Kosovë,

Në bazë të ligjit Nr.05/L-044 për Zonën e Rrezikuar Mjedisore të Obiliqit dhe rreth tij dhe ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale, kërkojmë nga ana e juaj për veprime të mënjëhershme dhe konkrete, për të gjetur një zgjidhje lidhur me nenin 8 të paragrafi 2 nënparagrafi 2.1 të ligjit Nr.05/L-044 për Zonën e Rrezikuar Mjedisore të Obiliqit dhe rreth tij ku shprehimisht theksohet se:

Neni 8 - *Masat shtesë për përmirësimin e jetës së banorëve të Zonës së Veçantë*

1. Qeveria në bashkëpunim me Komunën, krijon lehtësira të vazhdueshme për banorët e Zonës së Veçantë,

2. Qeveria në bashkëpunim me Zyrën e Rregullatorit te Energjisë siguron:
2.1. një kuotë më të ulët të çmimit për energji elektrike,

Komuna bazuar në nenin e lartcekur është e kufizuar të veprojë lidhur me çështjen e sigurimit të një kuote me të lirë të çmimit të energjisë elektrike për banorët e zonës së rrezikuar të Obiliqit dhe rreth tij.

Kërkojmë nga ju si Qeveri dhe Bord i ZRRE-së, së bashku me mekanizmat tuaj që të ndërmerrni hapat e nevojshëm lidhur me këtë çështje, sepse kanë kaluar pesë (5) vite që nga koha e miratimit të ligjit në fjalë përkatësisht hyrjes në fuqi të tij, dhe nuk është rregulluar kjo çështje e cila është shumë me rëndësi për qytetarët e komunës e Obiliqit.

Që nga fillimi i implementimit të buxheti, komuna në vitin 2019 ka ndërmarrë disa veprime për përmirësimin e jetës së banorëve të Zonës së Veçantë përkatësisht realizimin e kësaj çështje, ku me ndarje buxhetore ka paraparë që në emër të subvencionimit të energjisë elektrike të ndahen treqindmijë euro (300.000.00 €),për këtë çështje institucioni komunal ka krijuar një grup punues i cili ka bërë evidentimin e të gjithë njëhësoreve aktiv të energjisë elektrike për ekonomitë familjare, mirëpo të njëjtat mjete kanë mbetur pa u realizuar për shkaqe të mungesës së akteve nënligjore që e rregullojnë çështjen e kuotizimit më të ulët për banorët e Obiliqit e që sipas ligjit është në kompetencë të Qeverisë së bashku me ZRRE.

Ne si komunë që nga koha e miratimit të ligjit në fjalë përkatësisht që nga koha e hyrjes në fuqi të tij kemi bërë përpjekje të vazhdueshme duke dërguar kërkesa të ndryshme tek të gjitha ministritë përgjegjëse të cilat e kanë obligim rregullimin e akteve nënligjore për ligjin në fjalë, mirëpo nuk kemi marrë asnjë përgjigje pozitive.

Duke u bazuar në këtë, kërkojmë nga Komisioni Parlamentar, Qeveria e Republikës së Kosovës, ZRRE-ja, KEDS/KESCO, të trajtojnë me seriozitet këtë çështje dhe të krijojnë një modalitet sikurse në rastin e komunave veriore, ku për komunën e Obiliqit përcaktohet sipas ligjit Nr.05/L-044, neni 8, pika 2:***"Qeveria në bashkëpunim me Zyrën e Rregullatorit te Energjisë siguron: 2.1. një kuotë më të ulët të çmimit për energji elektrike,"***. Komuna e Obiliqit, komunë që gjendet mbi pasurinë e thëngjillit është e gatshme për bashkëpunim në gjetjen e zgjidhjes së përshtatshme për banorët e Obiliqit duke ofruarkoutë më të ulët të çmimit të energjisë elektrike dhe jo ngritje të tarifave, sipas Ligjit për Obiliqin dhe pasojat që bartë qytetari i Obiliqit nga i prodhimi i energjisë elektrike, nga veprimtaria e termocentraleve KOSOVA A dhe B, duke shkaktuar dëme të rënda shëndetësore.

Njëkohësisht, komuna e Obiliqit i vlerëson jashtëzakonisht të papranueshme, diskutimet për rritjen e tarifës (koutës) së energjisë elektrike, ne duke u bazuar në Ligjin për Obiliqin, fuqishëm e mbrojmë të drejtën e qytetarëve të Obiliqit për tarifë (koutë) më të ultë të energjisë elektrike dhe për këtë fakt ne do t'i ndjekim edhe veprimet e tjera ligjore lidhur me këtëçështje.

Me respekt,